



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.60

18 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.309, datë 21.4.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.243, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”	2467
Vendim i KM nr.311, datë 21.4.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të një pjese të pasurisë së paluajtshme, pronë shtetërore, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për projektin “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit-rruga e re, Tiranë-Elbasan)”	2469
Vendim i KM nr.315, datë 23.3.2011	Për përcaktimin e rregullave dhe për mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore	2473
Vendim i KM nr.317, datë 21.4.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”	2479
Vendim i KM nr.318, datë 21.4.2011	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.12.2010, për çështjen nr.32907/07 “Gjyli kundër Shqipërisë”	2479
Vendim i KM nr.319, datë 21.4.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.1301, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV, Tiranë-Podgoricë, në qarkun e Shkodrës”	2480

Vendim i KM nr.320, datë 21.4.2011	Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese	2482
Vendim i KM nr.321, datë 21.4.2011	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	2487
Kërkesë e MPPT nr.1390/5, datë 25.4.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës”.....	2488
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Skënder Bathorja	2494

VENDIM
Nr.309, datë 21.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.243, DATË 13.4.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR BULEVARDI “BAJRAM CURRI” DERI NË RRUGËN
“ALI DEMI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.243, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në pikën 3 të vendimit, bëhen këto ndryshime:

- Sipërfaqja truall, nga 5 621 (pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e një) m², bëhet 5 612 (pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) m²;

- Vlera e përgjithshme, prej 167 668 810 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekësh, bëhet 167 400 348 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë.

b) Në listën bashkëlidhur vendimit nr.243, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet numri i pasurisë për bashkëpronarët Hyka, i cili, nga 8/542, bëhet 8/557.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kompensimi i pronarëve, për efekt shpronësimi, të fillojë më 15.4.2011 dhe të përfundojë më 15.7.2011.

4. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë bashkisë Tiranë.

5. Bashkia Tiranë të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga bashkia e Tiranës dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, bashkia e Tiranës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BASHKIA E TIRANËS

Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik

BULEVARDI “BAJRAM CURRI” - RRUGA “ALI DEMI”

LISTA E PRONARËVE, VLERA NË LEKË DHE SIPËRFAQJA QË PREKET, SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Nr.	Pronari	Z.K.	Nr.pas	Numrat e pasurive dhe të dhënat e tjera sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 13.4.2010			Nr. i pasurisë pas ndryshimit	Sipërfaqja dhe të dhënat e tjera pas saktësimit nga ZVRPP-ja			Shënime
	Emri Mbiemri			Sip.në m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	
1	Bashkëpronarët “Hyka”	8150	8/542	317	29 829	9 455 793	8/557	317	29 829	9 455 793	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Vladimir Luçi	8150	8/450	72	29 829	2 147 688	8/450	63	29 829	1 879 227	Konfirmuar nga ZRPP-ja
				389		11 603 481		380		11 335 020	

VENDIM
Nr.311, datë 21.4.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NJË PJESE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË SHTETËRORE, MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR PROJEKTIN “NDËRTIM RRUGA UNAZA E RE E TIRANËS
(SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E RE, TIRANË-ELBASAN)”**

Në mbështetje të neneve 42 e 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi dhe transferimin e mjedisit e të sipërfaqes 9 264 (nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) m² pronë në administrim të institucioneve shtetërore, pjesë e pasurive shtetërore, me emërtimin “Kopshti Botanik”, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, për projektin “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit-rruga e re, Tiranë-Elbasan)”, pjesë e Unazës së Madhe të Tiranës, sipas planimetrisë që jepet në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masat për fillimin e ekzekutimit të punimeve të zbatimit të projektit “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit-rruga e re, Tiranë-Elbasan)”, në sipërfaqen e caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, pasi të ketë përfunduar rrethimi i ri i Kopshtit Botanik.

3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të njoftojnë drejtuesit administrativë të Kopshtit Botanik për marrjen e masave administrative për zhvendosje eventuale të vlerave të florës që preken nga transferimi i pasurisë sipas pikës 1 të këtij vendimi, nëse ka të tilla, dhe të bazës materiale përpara fillimit të procedurës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Të gjitha shpenzimet për lirimin e sheshit sipas planimetrisë 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pronë shtetërore, dhe përfundimin e punimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.


5. Kopshtit Botanik, për mbulimin e shpenzimeve operative për transferim të vlerave bimore sipas pikës 2 të këtij vendimi, t’i jepet nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e institucionit të miratuar për vitin 2011, zëri “Shpenzime korente”, shuma 200 000 (dyqind mijë) lekë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha







VENDIM
Nr.315, datë 23.3.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PËR MËNYRËN E REALIZIMIT TË
PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave dhe të mënyrës së realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Kombëtare e Akreditimit, Cilësisë dhe Sigurisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË PROCESIT TË
AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, sigurisë dhe performancës së institucioneve shëndetësore nëpërmjet veprimtarisë së brendshme dhe të ndërgjegjshme të tyre.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për të arritur dhe përmirësuar vazhdimisht standardet, si dhe mbrojtjen e pacientëve, konsumatorëve dhe qytetarëve nga praktika e keqe mjekësore, ajo e rrezikshme apo abuzive, si dhe t'i dëshmojë atyre, që institucioni shëndetësor është në gjendje të ofrojë çka duhet, ashtu siç duhet dhe atëherë kur duhet, në përmbushje të nevojave dhe pritshmërisë shëndetësore të popullatës.

Neni 3
Përkufizimet

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Akreditim” nënkupton vërtetim direkt të plotësimit të standardeve specifike nga institucionet shëndetësore përmes vizitës dhe vlerësimit të jashtëm në vendin e punës së institucionit përkatës lidhur me atë se çfarë kryhet në atë institucion: produktet, proceset, sistemet, personelin

ose ekipet, përfshirë këtu edhe një demonstrim formal të kompetencës së institucionit për të realizuar detyra të caktuara dhe në këtë kuptim, fjala “akreditoj” lidhet me këtë proces vizite konstatimi apo vlerësimi të jashtëm.

b) “Certifikata e akreditimit” nënkupton një dokument që përshkruan me shkrim deklaratën se akreditimi i është dhënë një institucioni të caktuar, i cili ofron shërbim shëndetësor, bazuar kjo në disa standarde të përcaktuara më parë.

c) “Emblema e akreditimit” nënkupton një simbol në formë embleme që jepet nga trupi akreditues që të përdoret nga institucioni për të demonstruar statusin e akreditimit të fituar nga institucioni përkatës.

d) “Institucion shëndetësor” janë të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shëndetësisë.

e) “Vlerësim i jashtëm” nënkupton një sërë aktiviteteve për të parë dhe konstatuar në vend plotësimin në vazhdimësi të standardeve të miratuara dhe publikuara që duhet të përmbushen nga institucioni për t’u akredituar.

f) “Pezullim të akreditimit” nënkupton aktin e heqjes së përkohshme të statusit të akreditimit, plotësisht (si institucion) ose pjesërisht (vetëm një ose disa shërbime të atij institucioni nuk plotësojnë standardet).

g) “Heqje e akreditimit” nënkupton aktin e ndërprerjes përfundimtare të statusit të akreditimit.

KREU II INSTITUCIONET AKREDITUESE

Neni 4 **Akreditimi i institucioneve shëndetësore**

Një institucion shëndetësor akreditohet nëse përmbush standardet e njohura nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 5 **Akreditimi i laboratorëve mjekësorë**

1. Akreditimi i laboratorëve mjekësorë kryhet së bashku me akreditimin e institucionit shëndetësor ku laboratorët janë të vendosur (spitale, qendra shëndetësore ose diagnostike, publike e private) sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

2. Laboratorët mjekësorë, përpara akreditimit të tyre sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore, duhet të pajisen me një certifikatë të kompetencës sipas standardit SSH ISO 15 189 nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për aspekte të standardeve teknike dhe kalibrimit të pajisjeve dhe aparaturave, lidhur me korrektesën matëse të tyre.

Neni 6 **Institucionet akredituese**

1. Institucionet që përfshihen në procesin e akreditimit të institucioneve shëndetësore janë:

a) Ministria e Shëndetësisë;

b) Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të institucioneve shëndetësore (QKCSA-ISH);

c) Këshilli i akreditimit.

Neni 7
Ministri i Shëndetësisë

1. Ministri në procesin e akreditimit ka të drejtën e vendimmarrjes për akreditimin e institucionit shëndetësor. Ministri, pasi shqyrton rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, brenda një afati 30 ditor, vendos:

- a) të japë akreditimin;
- b) të zgjerojë akreditimin;
- c) të japë një akreditim të pjesshëm;
- d) të refuzojë akreditimin;
- e) të pezullojë akreditimin;
- f) të heqë një akreditim.

Neni 8
Këshilli i Akreditimit

1. Këshilli i Akreditimit (KA) të institucioneve shëndetësore është organ këshillimor i Ministrisë të Shëndetësisë që përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë:

- a) një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
- b) një përfaqësues i QKCSA-ISH;
- c) një profesionist shëndetësor me gradë ose titull shkencor;
- d) një përfaqësues i ISKSH-së;
- e) një përfaqësues nga shoqatat e pacientëve.

2. Ministri i Shëndetësisë përcakton kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e Këshillit të Akreditimit.

3. Drejtori i QKCSA-ISH i kërkon të gjitha institucioneve të sipërpërmendura të caktojnë përfaqësuesin e tyre në Këshillin e Akreditimit. Për sa i përket përfaqësuesit të përcaktuar në germën “c”, Drejtori i QKCSA-ISH propozon dy kandidatura nga radhët e elitës mjekësore dhe Ministri i Shëndetësisë miraton një prej tyre.

4. Këshilli zgjidhet për një mandat 3-vjeçar me të drejtë rinovimi vetëm një herë.

5. Kryetari i Këshillit të Akreditimit zgjidhet minimalisht midis 2 kandidaturave, me votim të fshehtë nga anëtarët e KA-së për një mandat 3-vjeçar që mund të përsëritet vetëm një herë.

6. Këshilli i Akreditimit ka të drejtë që të thërrasë specialistë të fushave shëndetësore rast pas rasti në varësi të profilit të institucionit shëndetësor që do të akreditohet.

Neni 9
Kompetencat e Këshillit të Akreditimit

1. Këshilli i Akreditimit ka këto kompetenca:

- a) Vlerëson raportin e paraqitur nga vlerësuesit e jashtëm.
- b) Harton rekomandimin për ministrin, bazuar në raportin e vlerësuesve të jashtëm.
- c) Kërkon të dhëna e dokumente të mëtejshme nga QKCSA-ISH-ja, nga ISH-ja që është në vlerësim dhe nga çdo institucion që zotëron informacione për ISH-në dhe që ndihmon për marrjen e një vendimi sa më të drejtë.
- d) Dëgjon dhe shqyrton ankesat e mundshme të institucioneve që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm dhe vendos për to.
- e) Dërgon te Ministri i Shëndetësisë rekomandimin lidhur me akreditimin.

2. Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Akreditimit propozohet nga QKCSA-ISH-ja dhe miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.

3. Anëtarët e Këshillit të Akreditimit shpërblehen në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

KREU III PROCESI I AKREDITIMIT

Neni 10

Kërkesa për akreditim

1. Çdo institucion, në zbatim të ligjit, detyrohet që të bëjë kërkesë me shkrim për akreditim dhe të plotësojë formularin përkatës, model i cili i bashkëlidhet vendimit pranë QKCSA-ISH-së.

2. Pas depozitimit të kërkesës dhe plotësimit të formularit, QKCSA-ISH-ja i jep institucionit shëndetësor standardet e shkruara të publikuara, si dhe dokumentacionin bashkëshoqërues ndihmës për vetëvlerësim.

3. Standardet shëndetësore të akreditimit të shërbimeve miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 11

Procesi i vetëvlerësimit

1. Institucioni shëndetësor pas aplikimit pranë QKCSA-ISH-së, me anë të një grupi të brendshëm pune, vlerëson vetveten përkundrejt standardeve të akreditimit, si dhe identifikon arritjet dhe mangësitë, si dhe drejtimet apo fushat për përmirësim të mëtejshëm.

2. Kohëzgjatja e vetëvlerësimit dhe e vetëpërmirësimit deri në kërkesën nga ana e tyre, nuk duhet të kalojë 2 (dy) vjet.

3. Aplikanti mund të kërkojë ndihmë apo sqarime lidhur me vetëvlerësimin nga stafi i QKCSA-ISH-së. QKCSA-ISH-ja asiston në procesin e vetëvlerësimit dhe ndihmon institucionin për përmirësime të mundshme.

4. Në përfundim të vetëvlerësimit institucioni shëndetësor hedh të dhënat përfundimtare të vetëvlerësimit në *software*-in e posaçëm të QKCSA-ISH-së.

Neni 12

Vlerësimi i jashtëm

1. Institucioni Shëndetësor (ISH), pasi ka mbaruar procedurën e vetëvlerësimit, aplikon për vlerësimin e jashtëm. QKCSA-ISH-ja planifikon datën e vlerësimit dhe brenda 2 javëve ia komunikon ISH-së.

2. QKCSA-ISH-ja harton programin e vlerësimit të jashtëm akreditues dhe njofton paraprakisht titullarin e institucionit shëndetësor për programin që do të ndjekë ekipi i vlerësuesve të jashtëm dhe përbërjen e tij. Njëri nga anëtarët e ekipit zgjidhet si drejtues.

3. QKCSA-ISH-ja bën ndryshime në ekip në rast ankesash apo sugjerimesh të argumentuara nga institucioni shëndetësor që do të akreditohet lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi për ndonjërin prej tyre.

4. Vlerësimi i jashtëm akreditues kryhet në datat e paracaktuara nga QKCSA-ISH-ja dhe institucioni shëndetësor, nga ana e grupit të vlerësuesve të jashtëm të QKCSA-ISH-së.

5. Drejtoria e institucionit shëndetësor njofton personelin e saj për vlerësimin e jashtëm akreditues dhe qëllimet e tij dhe është e detyruar të vërë në dispozicion të ekipit dokumentacionin, mjediset dhe mjetet e nevojshme, si dhe lejen me shkrim për akses në çdo hallkë, për të takuar dhe bërë vlerësime me personelin, pacientët etj. Institucioni duhet t'i ofrojë ekipit kushte optimale pune, pavarësi, mbrojtje dhe mbështetje nga çdo ndikim.

Neni 13

Vlerësuesit e jashtëm

1. Vlerësuesit e jashtëm janë profesionistë dhe menaxherë shëndetësorë të trajnuar nga QKCSA-ISH-ja, për procesin e vlerësimit të jashtëm.

2. Mënyra e përzgjedhjes dhe kriteret që duhet të plotësojnë vlerësuesit e jashtëm, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 14

Hartimi i draftreportit të vlerësimit të jashtëm akreditues

1. Grupi i vlerësuesve të jashtëm harton brenda 2 javësh draftreportin e vlerësimit lidhur me përputhjen me standardet dhe ia paraqet drejtorisë së institucionit dhe grupit të vetëvlerësimit për komente dhe sugjerime të mundshme.

2. Grupi i vlerësuesve të jashtëm mund të marrë parasysh ose jo vërejtjet e drejtorisë dhe grupit të vetëvlerësimit dhe brenda një jave nga ky takim, dorëzon raportin final të vlerësimit të firmosur nga të gjithë anëtarët e ekipit, pranë QKCSA-ISH-së. QKCSA-ISH-ja i jep një kopje të këtij raporti drejtorisë së institucionit.

3. Drejtoria e institucionit, në rast pakënaqësisë ndaj këtij raporti, ka të drejtë të paraqesë ankesa në QKCSA-ISH, brenda 2 javësh.

Neni 15

Vlerësimi nga Këshilli i Akreditimit

1. Pas marrjes në dorëzim të raportit final nga grupi i vlerësuesve të jashtëm, QKCSA-ISH-ja përgatit për mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Akreditimit, dosjen e plotë për institucionin në të cilin është kryer vlerësimi i jashtëm.

2. Këshilli i Akreditimit merr në shqyrtim dokumentacionin përkatës të dosjes të sipërpërmendur dhe me shumicë votash rekomandon:

a) nëse spitali apo institucioni nuk ka qenë i akredituar ndonjëherë ose i është hequr akreditimi, i jepet:

- i) statusi i akreditimit (kur realizimi i standardeve $> 80\%$);
- ii) akreditim i pjesshëm (kur realizimi i standardeve $> 70\%$ dhe $< 80\%$);
- iii) të mos i jepet akreditimi (kur realizimi i standardeve $< 70\%$).

b) nëse spitali apo institucioni është i akredituar më parë:

- i) i rijepet statusi i akreditimit;
- ii) i jepet akreditim i pjesshëm;
- iii) i hiqet akreditimi; ose
- iv) pezullohet me kusht ose afat kohor;
- v) i rijepet ose të vazhdojë akreditimi, pas pezullimit.

Neni 16

Vendimi për akreditim

1. QKCSA-ISH-ja i dërgon rekomandimin e Këshillit të Akreditimit, Ministrit të Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë, bazuar në rekomandimin e Këshillit të Akreditimit, merr vendimin për akreditimin e institucionit shëndetësor, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, brenda një afati 30-ditor.

2. Kundër vendimit të Ministrit të Shëndetësisë bëhet ankim në gjykatë, brenda 30 ditëve.

Neni 17

Shpallja dhe botimi i rezultateve të vlerësimit

1. QKCSA-ISH-ja, në rast akreditimi dorëzon certifikatën përkatëse së bashku me emblemen e akreditimit, të cilat institucioni shëndetësor ka të drejtë t'i afishojë në një vend të dukshëm për publikun.

2. QKCSA-ISH-ja mban, publikon dhe përditëson listën e institucioneve shëndetësore të akredituara.

Neni 18

Certifikata dhe emblema e akreditimit

1. Institucioni shëndetësor i akredituar, pajiset nga QKCSA-ISH-ja me një certifikatë akreditimi të firmosur nga Ministri dhe një emblema të posaçme, të cilat vendosen në institucion në një vend të dukshëm për publikun.
2. Ato duhet të hiqen prej andej vetëm nëse statusi i akreditimit i ndërpritet, pezullohet apo i ka kaluar afati.
3. Format i certifikatës miratohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 19

Riaplikimi për akreditim

Në rastet kur institucionit nuk i është dhënë akreditimi ose i është hequr apo pezulluar, atëherë institucioni mund të riaplikojë, por jo më përpara se 6 muaj nga data e këtij vendimi.

Neni 20

Mbikëqyrja e akreditimit

QKCSA-ISH-ja kryen mbikëqyrje të akreditimit të paktën një herë në vit. Qëllimi i kësaj mbikëqyrjeje është vlerësimi i vazhdueshmërisë së plotësisë të standardeve për akreditim.

KREU IV

FINANCIMI DHE AFATET E AKREDITIMIT

Neni 21

Tarifat e akreditimit

1. Lista e shërbimeve të kryera nga QKCSA-ja lidhur me kryerjen e procesit të akreditimit, hartohet prej saj dhe miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.
2. Tarifat për kryerjen e gjithë procesit të akreditimit, propozohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.
3. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për procesin e akreditimit, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 22

Afatet kohore

1. Institucionet shëndetësore aplikojnë për akreditim pranë QKCSA-ISH-së, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore, brenda 2 (dy) vjetëve nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Akreditimi bëhet në mënyrë të detyrueshme dhe periodike çdo 5 (pesë) vjet.
3. Certifikata e Akreditimit vlen për periudhë kohore 5-vjeçare (pesë). Pas përfundimit të tij, institucioni duhet të aplikojë për riakreditimin, përpara skadimit të afatit 5- vjeçar (pesë).

VENDIM
Nr.317, datë 21.4.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10,12,13 e 15/c të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas formulave bashkëlidhur.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi përbëhet nga 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.318, datë 21.4.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.12.2010, PËR ÇËSHTJEN NR.32907/07 “GJYLI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.12.2010, për çështjen nr.32907/07, “Gjyli kundër Shqipërisë”, në shumën 7200 (shtatë mijë e dyqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat, për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave. Afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 7.6.2011.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z.Ali Gjyli, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Ali Gjyli, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.319, datë 21.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1301, DATË 29.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV, TIRANË-PODGORICË, NË QARKUN E SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1301, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme prej 9 617 (nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 84 444 549 (tetëdhjetë e katër milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi, prej 84 444 549 (tetëdhjetë e katër milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTESA E LISTËS SË PRONARËVE PËR SHPRONËSIM, PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS SË TENSIONIT TË LARTË
400 KV TIRANË-PODGORICË E QARKUT SHKODËR

Qarku: Shkodër
Komuna: Hajmel

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv									
		Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr.kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. pronës m ²	Çmim shitje ZRPP	Vlera e kompensimit	Adresa	Informacion
1	Linja 400 kV	Jak	Qemeqi	Shtëpi nën linjë	1920	430/4	230	35593.5	8 186.505	Hajmel	Me certifikatë pronësie
		Pjetër	Qemeqi								
8 186 505											

VENDIM
Nr.320, datë 21.4.2011

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE E TË KRITEREVE TË KONKURRIMIT DHE TË AFATEVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT KONKURRUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3, e 56, pika 1, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 36/1 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e së drejtës së plotësimit të dokumentacionit të plotë për një leje minerare në zonat minerare të përcaktuar në planin mineral, si zona konkurruese, subjekteve fituese të një konkurrimi publik.

Përcaktimi fitues i procedurës së konkurrimit publik i jep fituesit të drejtën ekskluzive që:

a) për periudhën prej jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike, pas miratimit të tij si subjekt fitues, të paraqesë dokumentacionin e plotë të aplikimit për leje pranë sporteleve të QKL-së. Mosrespektimi në kohë i këtij afati i heq të drejtën e aplikimit për leje dhe kjo e drejtë i kalon subjektit të dytë fitues në garën e konkurrimit publik. Mosrespektimi i afatit nga ky i fundit i jep të drejtën subjektit fitues, të tretë. Në rastin kur dhe ky fitues nuk respekton afatin e plotësimit të dokumentacionit, zona rishpallet për konkurrim.

b) për periudhën, e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1, pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) zona e kërkuar për leje minerare quhet “zonë e kërkuar” dhe nuk lejohet asnjë subjekt tjetër të aplikojë në këtë zonë minerare për leje minerare kërkim-zbulimi, shfrytëzimi apo kërkim-zbulim-shfrytëzimi.

2. Dokumentacioni i plotë i aplikimit për një leje minerare kërkim-zbulimi, shfrytëzimi ose leje minerare kërkim-zbulimi-shfrytëzimi nga ana e fituesit të një procedure të konkurrimit publik bëhet pranë sporteleve të QKL-së. Data e aplikimit të dokumentacionit të plotë është data e përlogaritjes së afatit për miratimin e heshtur.

3. Përmbajtja e dokumentacionit të plotë të aplikimit dhe procedurat e shqyrtimit e të miratimit të tij janë të njëjta me ato kërkesa që duhet të plotësojnë subjektet kur aplikojnë për marrjen e një lejeje minerare në zonat e hapura.

4. Procedura e konkurrimit është e hapur për subjektet juridike, vendase apo të huaja.

5. Çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para përfundimit të vitit kalendarik, në përputhje me planin vjetor mineral, shpallen zonat minerare, të cilat kalojnë në procedurë konkurrimi publik.

6. Në njoftimin për hapjen e procedurave konkurruese përfshihet zona minerare, që kalon në proces konkurrimi publik, e përcaktuar në hartë me shkallë 1:25000, sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal dhe të dhënat gjeologo-minerare për zonën minerare konkurruese.

7. Miratimi i rregullave për procedurat konkurruese për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese, i kritereve të konkurrimit dhe i afateve të shqyrtimit të kërkesave bëhet, si më poshtë vijon:

7.1 Autoriteti kontraktues është përgjegjës për vlerësimin e kritereve, të kushteve të plotësimit të këtyre kritereve dhe të procedurave konkurruese për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese me leje minerare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe të këtyre rregullave.

7.2 Autoriteti kontraktues mban regjistrin e konkurrimit publik, i cili ruhet dhe administrohet nga autoriteti kontraktues për një periudhë kohe njëvjeçare dhe në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat.

7.3 Ky regjistër përmban, të paktën:

- a) emërtimin e autoritetit kontraktues;
- b) adresën e autoritetit kontraktues;
- c) objektin e konkurrimit të paraqitur në hartë me shkallë 1:2500, sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal dhe të dhënave gjeologo-minerare për objektin në konkurrim;
- ç) vlerën minimale të investimit që kërkohet të realizohet për objektin në konkurrim;
- d) emrat e anëtarëve të grupit të hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik;
- dh) emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave;
- e) emrat dhe adresat e ofertuesve;
- ë) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- f) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e garës dhe përgjigjen e tyre;
- g) një përmbledhje të ankesave të bëra dhe për zgjidhjen e tyre.

7.4 Pasi është përcaktuar oferta fituese apo nëse procedura konkurruese quhet e pasuksesshme, përmbajtja e regjistrit të konkurrimit publik për zonat konkurruese minerare apo pjesë e tij i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar me kërkesë të tij, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

7.5 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, sipas fushës së veprimtarisë që mbulojnë, në përputhje me kërkesat e programit trevjeçar të strategjisë minerare, planit vjetor minerar, si dhe studimet përkatëse që disponohen nga këto institucione, projektidetë teknike dhe financiare, bëjnë identifikimin e zonave konkurruese që kalojnë në procedurën e konkurrimit publik.

7.6 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore bëjnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare për të vendosur nëse zona minerare duhet shpallur si zonë konkurruese. Kjo analizë mbështetet në parimet e vlerës maksimale të projektit përkundrejt parave që kërkohen, në përputhshmërinë e zhvillimit të veprimtarive minerare të mundshme me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin teknik dhe tregtar dhe aftësinë e tyre për të tërhequr investitorë të mundshëm shtetërorë ose privatë. METE dhe/ose autoritetet vendore përkatëse asistojnë në këtë proces.

7.7 Pas kryerjes së analizës së rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare dhe pasi zona konkurruese vlerësohet me interes për zhvillimin e veprimtarive minerare, AKBN-ja dhe SHGJSH-ja, sipas fushës së veprimtarisë që mbulojnë, propozojnë fillimin e procedurave për konkurrimin publik, nëpërmjet një urdhri, të nxjerrë nga ministri.

7.8 Ministri, në urdhrin e miratimit të fillimit të procedurave konkurruese, përcakton autoritetin kontraktues, njësinë e hartimit të dokumentacionit dhe organizimin e procedurave konkurruese, komisionin e vlerësimit të ofertave, pjesëmarrjen e konsulentit të specializuar, vendas ose të huaj, në rast se autoriteti kontraktues e konsideron të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

7.9 Procedurat konkurruese të përzgjedhjes (më poshtë “procedurat konkurruese”) realizohen nga autoriteti kontraktues, pas miratimit të tij, dhe në këto procedura përfshihen hapat, si më poshtë vijon:

- a) Nxjerrja e urdhrit për fillimin e procedurave për konkurrimin publik;
- b) publikimi i ftesës për ofertë që përmban:
 - i) ftesën për pjesëmarrje në procedurë konkurruese, si dhe datën e orën e zhvillimit të tij;
 - ii) dokumentet standarde të procedurës konkurruese, që duhet të paraqesë ofertuesi;
 - iii) objektin e konkurrimit të paraqitur në hartë me shkallë 1:25000, sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal dhe të dhënat gjeologo-minerare për objektin në konkurrim;
 - iv) vlerën minimale të investimit që kërkohet të realizohet për objektin në konkurrim;
- c) Ftesa për ofertë botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe shpallet në *web-site*-in e institucionit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Afati i publikimit duhet të jetë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike pas miratimit të planit vjetor minerar;
- ç) Ftesa për ofertë, për çdo lloj procedure konkurruese që publikohet, përmban domosdoshmërisht kushtet e mëposhtme, që duhet të plotësohen nga ofertuesit:

i) të paraqesin vetëm një ofertë;
ii) të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese;
iii) të pranojnë detyrimet, që rrjedhin nga shpallja fitues gjatë procedurës konkurruese;
iv) të bien dakord që shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurë konkurruese nuk rimbursohen nga autoriteti kontraktues;

d) Dokumentet standarde të procedurës konkurruese përgatiten nga autoriteti kontraktues dhe nënkuptojnë:

i) informacionin e përgjithshëm, ku përfshihen:
- formulari i ftesës për ofertë me kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të konkurrimit, vendi, data dhe ora për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre, gjuha/gjuhët e ofertave dhe dokumenteve; informacione të mëtejshme, të konsideruara si të dobishme nga autoriteti kontraktues;

- formulari i njoftimit të fituesit;
- formulari i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- formulari i ankesës.

ii) informacionin specifik, ku përfshihen:
- objekti i konkurrimit të paraqitur në hartë me shkallën 1:25000, sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal, dhe të dhënat gjeologo-minerare për objektin në konkurrim;
- vlera minimale e investimit që kërkohet të realizohet për objektin në konkurrim;
- kërkesat ligjore, profesionale dhe ekonomiko-financiare për kualifikim;
- kriteret e shpalljes së fituesit;
- termat e referencës për procedurën konkurruese.

7.10 Oferta përfshin emrin dhe adresën e subjektit, referencën e njoftimit për procedurën konkurruese, objektin mineral, vlerën e investimit, realizimin për kërkesat e përgjithshme dhe specifike për kualifikim.

7.11 Formulari i njoftimit të fituesit përgatitet pas miratimit të klasifikimit përfundimtar nga titullari i autoritetit kontraktues. Ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës së tij dhe për fillimin e përgatitjes së dokumentacionit për marrjen e lejes minerare. Ky njoftim i dërgohet edhe APP-së me qëllim publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike. Data e publikimit është data për fillimin e llogaritjes së afatit 60-ditor (gjashtëdhjetë) kalendarik për përgatitjen e dokumentacionit të plotë të lejes minerare dhe paraqitjen e tij në sportelet e QKL-së. Njoftimi përmban referencën e procedurës, emrin dhe adresën e saktë të ofertuesit të shpallur fitues, emrin e objektit mineral, vlerën e investimit, emrat e ofertuesve të skualifikuar.

7.12 Formulari i ankesës u shërben ofertuesve për dorëzimin e ankesës administrative, lidhur me veprimet ose mosveprimet e autoritetit kontraktues. Formulari i ankesës përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin e nënshkrimit të tij dhe duhet të jetë i publikuar në faqen e internetit të institucionit dhe të APP-së.

7.13 Për vlerësimin e kapaciteteve ligjore, ekonomiko-financiare dhe profesionale respektohen kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, apo kërkesa specifike të shpallura nga autoriteti kontraktues.

7.14 Autoriteti kontraktues krijon njësinë e hartimit të ofertave dhe dokumentacionit përkatës, e cila përbëhet nga të paktën 4 (katër) anëtarë, me të paktën 1 (një) jurist në përbërje të saj. Kjo njësi është përgjegjëse për:

- a) hartimin e dokumenteve të garës, të kërkesave për kualifikim dhe të kriterëve të vlerësimit;
- b) hartimin e regjistrimit të konkurrimit publik për objektin konkret;
- c) hartimin dhe dërgimin e njoftimeve;
- ç) mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të nevojshme, të cilat kanë të bëjnë me procedurën konkurruese;
- d) detyra që i ngarkohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Specifikimet teknike përgatiten nga AKBN-ja e SHGJSH-ja për objektet që shpallen për konkurrim apo edhe nga subjekte të specializuara kur kjo ekspertizë mungon. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të hartimit të dokumenteve, i cili është caktuar me urdhër të ministrit.

7.15 Pas hartimit të dokumenteve të procedurës konkurruese dhe miratimit të tyre, miratohet publikimi i ftesës për ofertë. Në këtë njoftim bëhen të qarta ora, data dhe adresa për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre.

7.16 Ofertat dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese, brenda afatit kohor të specifikuar në dokumentet e procedurës konkurruese, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Menjëherë pas skadimit të afatit përfundimtar, komisioni për vlerësimin e ofertave fton përfaqësuesit e ofertuesve të paraqesin ofertat/propozimet e tyre, të mbyllura në zarf, ose verifikon ato çka mund të jenë dorëzuar më parë në një nga mënyrat e parashikuara në dokumentet e procedurës konkurruese. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktues nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave, dhe do t'i kthehet e pahapur ofertuesit. Ofertat do të dorëzohen në dy zarfe, ku në njërin të jetë shënuar “Original” dhe në tjetrin “Kopje”. Secili nga këto zarfe duhet të përmbajë kualifikimet e ofertuesit dhe ofertën financiare për vlerën e investimit. Autoriteti kontraktues përcakton në dokumentet e procedurës konkurruese numrin e kopjeve, që duhet të paraqesë ofertuesi. Zarfet paraqiten sipas përcaktimit në dokumentet standarde të procedurës konkurruese. Zarfet duhet të jenë të vulosura me vulën e ofertuesit pjesëmarrës në konkurrim. Mosparaqitja sipas përcaktimit apo mungesa e çdo elementi të përcaktuar për prezantimin e tij do ta bëjë ofertën e pavlefshme. Në këtë rast, oferta do të skualifikohet, por zarfi nuk do t'i kthehet ofertuesit.

7.17 Komisioni i vlerësimit të ofertave, i miratuar me urdhër të ministrit, përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, specialistë të fushës përkatëse të autoritetit kontraktues dhe është përgjegjës për miratimin e dokumenteve të garës dhe shqyrtimin e ofertave. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit përzgjidhet mes zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktues dhe është plotësisht përgjegjës për organizimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Komisioni zbaton detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohet ndonjë sqarim në lidhje me dokumentet e procedurës konkurruese, këto merren nga njësia e hartimit të dokumenteve. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këtë rregullore. Nuk mund të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave:

a) personat që janë në konflikt interesi me ofertuesit, sipas kuptimit të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;

b) personat që kanë lidhje gjaku, krushqie apo interesi me ofertuesit në procedurë konkurruese.

Anëtarët e komisionit dhe çdo person që ka marrë pjesë në procedurën e hartimit të dokumenteve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertës.

7.18 Hapja e dokumenteve është publike.

7.19 Hapja dhe vlerësimi i ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave bëhen, si më poshtë vijon:

a) Komisioni i vlerësimit të ofertave lexon ofertat në prani të ofertuesve, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim. Gjatë fazës së hapjes dhe vlerësimit mund të marrin pjesë edhe anëtarë të grupit të hartimit të dokumenteve të procedurës konkurruese, por nuk kanë të drejtë për të votuar ose për të ndihmuar në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime, vetëm kur iu kërkohet.

b) Komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më tej, hap zarfin e dokumenteve të kualifikimit dhe lexon listën e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi. Më pas, hap ofertën financiare. Komisioni i vlerësimit të ofertave u komunikon përfaqësuesve ditën, vendin dhe orën për klasifikimin përfundimtar të ofertuesve dhe më pas vazhdon punën për shqyrtimin e ofertave. Në fillim shqyrtohet dokumentacioni ligjor dhe kualifikues për aspektet profesionale dhe më pas oferta financiare për vlerën e investimit në objektin minerar.

c) Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të reflektuara në procesverbalin e konkurrimit. Bazuar në ofertat e pranuar, komisioni harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të komunikohet në kohën e përcaktuar në dokumentet e konkurrimit. Afati maksimal i vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave është deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit të ftesës së ofertës. Në raste të veçanta, me kërkesë të argumentuar të komisionit të vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues mund ta ndryshojë këtë afat, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike.

ç) Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

d) Kryetari i komisionit të vlerësimit, brenda 20 (njëzet) ditëve nga komunikimi me ofertuesit, përgatit raportin përmbledhës dhe ia propozon fituesin titullarit të autoritetit kontraktues. Raporti përmban:

- i) objektin mineral;
- ii) një përmbledhje të procedurës së ndjekur;
- iii) numrin e ofertave të paraqitura dhe një përmbledhje për çdo ofertë;
- iv) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimin sipas këtyre kriterëve të secilës ofertë;
- v) kriteret e përcaktimit të ofertës ekonomiko-financiare;
- vi) renditjen e ofertuesve, sipas vlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave;
- vii) ankesa, nëse ka.

dh) Të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së subjektit fitues. Procedurat e ankimit janë ato të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncensionet”, të ndryshuar.

e) Pas përfundimit të afatit të bërjes së ankesës nga ofertuesit, autoriteti kontraktues njofton fituesin për plotësimin e dokumentacionit për marrjen e të drejtave minerare.

7.20 Një ofertë deklarohet e pavlefshme nëse ofertuesi:

- a) ka dhënë të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- b) nuk ka plotësuar një nga tri kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese (kriterin ligjor, profesional, ekonomiko-financiar).

7.21 Procedura konkurruese quhet e pasuksesshme kur:

- a) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese;
- b) autoriteti kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave, shpall mbylljen e procedurës konkurruese.

8. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.321, datë 21.4.2011

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL
DHE KUALIFIKIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, të shkronjës “dh” të nenit 7 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në vijim (AKAFPK), si institucion juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për realizimin e këtij objekti, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve:

a) harton plane dhe programe për zhvillimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP), që miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

b) harton programe për realizimin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

c) harton programe për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së;

ç) mban regjistrin kombëtar të kualifikimeve profesionale.

3. AKAFPK-ja është një ofrues shërbimi për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Funksionet kryesore të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve janë:

a) rishikimi dhe hartimi i listës kombëtare të profesioneve dhe i përshkrimeve përkatëse;

b) rishikimi dhe hartimi i Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale (KKKP) me përshkrimin e standardeve për nivelet e drejtimeve dhe të kriterëve të vlerësimit të certifikimit;

c) rishikimi dhe hartimi i skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale;

ç) akreditimi i institucioneve që ofrojnë arsimim dhe formim profesional;

d) përcaktimi i standardeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, të personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional;

dh) përcaktimi i kriterëve për vlerësimin dhe certifikimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;

e) ndërtimi dhe rifreskimi i bazës së të dhënave për Kuadrin Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale (KKKP), për skeletkurrikulat, akreditimin, certifikatat e dhëna, nevojat për kualifikime profesionale, që lidhen me arsimin dhe formimin profesional.

5. AKAFPK-ja drejtohet nga drejtori dhe organizohet në sektorë.

6. Drejtori emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të caktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit”.

7. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, para nxjerrjes së aktit të emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, këshillohet me Këshillim Kombëtar të AFP-së dhe me këshillin e KSHK-së.

8. Përgjegjësit e sektorëve, specialistët dhe punonjësit e tjerë emërohen nga drejtori, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

9. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKAFPK-së rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve raporton një herë në vit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për çështjet e veprimtarisë së vet.

11. Funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve bëhet në përputhje me rregulloren, e cila, pas këshillimit me KKAFFP-në dhe KKSHPK-në, miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

12. Struktura dhe organika e AKAFPK-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas propozimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

13. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton statutin dhe rregulloren e funksionimit të AKAFPK-së.

14. Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për vitin 2011.

16. Për punonjësit, që humbasin vendet e punës pas riorganizimit, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

17. Vendimi nr.273, datë 10.5.2006 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional”, shfuqizohet.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

Nr.1390/5, datë 25.4.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për të gjitha pasuritë që figurojnë në listën ku janë pasqyruar sipërfaqet respektive që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, është bërë shënimi “Proces rikonfirmimi dhe saktësimi”, për arsye të të dhënave të pasakta dhe jo të plota, konfirmuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë (ZRPP).

Për pasuritë për të cilat pronari figuron i paidentifikuar, personat që pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, si dhe të paraqesin një kopje të dokumentacionit përkatës pranë MPPT-së, pasi nuk disponojnë të dhëna lidhur me pronarin.

Për objektet është bërë shënimi “Proces rikonfirmimi”, për arsye se do të rikërkohet konfirmim pranë ALUIZNI-t Tiranë, si dhe pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë (ZRPP).

Ju bëjmë me dije se në bazë të të dhënave që do të konfirmohen nga institucionet e sipërpërmendura, si dhe nga informacionet që do të mblidhen në terren, do të hartohen listat përfundimtare të cilat do të propozohen për shpronësim pranë Këshillit të Ministrave.

Lutemi qytetarëve, të cilët pretendojnë pronësinë, mbi objektet të cilat nuk janë përfshirë në procesin e legalizimeve apo nuk janë të regjistruara pranë ZRPP-së, të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë kësaj zyre, si dhe të paraqesin pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dokumentacionin tekniko-ligjor (nëse disponojnë të tillë), nëpërmjet të cilit vërtetojnë titullin e pronësisë mbi këto objekte.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 739 864 128 (shtatëqind e tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT
“UNAZA TIRANË”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Objekte

Nr.	Pronari		Vlera në lekë sipas preventivit	EMËRTIMI	Shënim
	Emri	Mbiemri		OBJEKTEVE	
1	EL FURKAN		9,564,352	Xhami	Proces rikonfirmimi
2	EL-FURKAN		15,485,662	Konvikti i xhamisë	Proces rikonfirmimi
3	NEKI	ELEZI	2,219,285	Karburant	Proces rikonfirmimi
4	HATLIE	DERVISHI	13,605,485	Lokal	Proces rikonfirmimi
5	RITVAN + ZAMIRA	GJINI	16,164,620	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
6	BILBIL	VECANI 1	1,460,207	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
7	BILBIL	VECANI 2	2,693,325	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
8	AHMET	KOLICI	16,568,948	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
9	ASTRIT	LACI	5,838,218	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
10	SIMON	RAJTA	4,028,618	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
11	SAMI	BRAHJA	11,188,018	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
12	ALBERT	MEMIA	5,484,919	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
13	ASTRIT	MUÇA	6,439,661	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
14	STILIANO	HAJDARI	11,776,449	Shtëpi banimi + lokal	Proces rikonfirmimi
15	ZENEL	HAJDARI	9,263,153	Shtëpi banimi + lokal	Proces rikonfirmimi
16	KUJTIM + LULJETA	BRARI	8,400,149	Lokal	Proces rikonfirmimi
17	FADIL	DURAKU	16,961,420	Shtëpi Banimi	Proces rikonfirmimi
18	FERIT	DURAKU	16,961,420	Shtëpi Banimi	Proces rikonfirmimi
19	ADELINA	GJUJZA	1,167,395	Lokal	Proces rikonfirmimi
20	HYSEN	MUÇA	13,583,061	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
21	NURI	PETI	15,971,708	Hotel	Proces rikonfirmimi
22	PETRIT	LACI	3,509,892	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
23	LEFTER	LILA	4,766,805	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
24	GJYLE	LACI	4,676,371	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
25	SKENDER	HARIZI	7,768,717	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
26	ARBEN	BRAJA	9,314,731	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
27	MARK	RAJTA	5,240,971	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
28	MUHARREM	ZANI	3,850,258	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
29	PERPARIM	HARIZI	4,157,017	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
30	AGRON	PETI	13,458,759	Lokal	Proces rikonfirmimi
31	BESIM	LAÇI	3,451,623	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
32	FATMIR	BRARI	10,900,596	Lokal	Proces rikonfirmimi
33	ARJAN	BRAJA (MUÇA)	3,182,463	Shtëpi banimi	Proces rikonfirmimi
34	I PAIDENTIFIKUAR		1,297,191	Zdruktuari	Proces rikonfirmimi
		TOTALI	280,401,467		

RRUGA “UNAZA E MADHE TIRANË”, SEGMENTI: “KOMUNA E PARISIT-
RRUGA E RE TIRANË-ELBASAN

Nr.	PRONARI			Z.K.	Nr. pas.	Nomenklatura	Tokë truall			Shënime
	Emri	Atësi	Mbiemri				Sip. m²	Çmimi	Vlera në lekë	
1	AGIM	ISLAM	ALLA	3292	100/4	K-34-100-(10-D)	1091	8527.5	9303502.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
2	RAMAZAN	ISLAM	ALLA	3292	101/28	K-34-100-(10-D)	1065	8527.5	9081787.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
3	HAKI	ISLAM	ALLA	3292	101/29	K-34-100-(10-D)	1082	8527.5	9226755	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
4	NUREDIN	ISLAM	ALLA	3292	101/30	K-34-100-(10-D)	1021	8527.5	8706577.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
5	14 B/P KIKA			3292	100/30	K-34-100-(10-D)	3400	8527.5	28993500	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
6	HALIL		PINARI	8270	8/337	(TR).U,V - 9,10	164	8527.5	1398510	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
7	DRITA		SHPENDI	8270	8/258	(TR).U,V - 9,10	30	8527.5	255825	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
8	ENVER		BRARI	8270	8/170	(TR).U,V - 9,10	18	8527.5	153495	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
9	DILE		TUSHA	8270	8/169	(TR).U,V - 9,10	4	8527.5	34110	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
10	I paidentifikuar			8270	8/428	(TR).U,V - 9,10	260	8527.5	2217150	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
11	I paidentifikuar			8270	8/429	(TR).U,V - 9,10	280	8527.5	2387700	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
12	I paidentifikuar			8270	8/512	(TR).U,V - 9,10	35	8527.5	298462.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
13	SABRI	SHAQIR	PINARI	8270	8/330	(TR).U,V - 9,10	800	8527.5	6822000	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
14	I paidentifikuar			8270	8/439	(TR).U,V - 9,10	231	8527.5	1969852.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
15	I paidentifikuar			8270	8/501	(TR).U,V - 9,10	123	8527.5	1048882.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
16	I paidentifikuar			8270	8/655	(TR).U,V - 9,10	85	8527.5	724837.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
17	I paidentifikuar			8270	8/407	(TR).U,V - 9,10	50	8527.5	426375	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
18	I paidentifikuar			8270	8/389	(TR).U,V - 9,10	12	8527.5	102330	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
19	B/P BRARI			8270	8/276	(TR).U,V - 9,10	263	8527.5	2242732.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
20	B/P BRARI			8270	8/277	(TR).U,V - 9,10	735	8527.5	6267712.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
21	B/P META			8270	8/78	(TR).U,V - 9,10	461	8527.5	3931177.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
22	B/P SINANI			8270	8/79	(TR).U,V - 9,10	636	8527.5	5423490	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
23	B/P KAIMI, XHAJA,TOSKA			8270	8/146	(TR).U,V - 9,10	146	8527.5	1245015	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
24	LAVDIJE	FERIT	BAKALLI	8270	8/147	(TR).U,V - 9,10	186	8527.5	1586115	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
25	VASILLAQ ZOTO +B/P			8270	8/352	(TR).U,V - 9,10	466	8527.5	3973815	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
26	B/P SINANI			8270	8/265	(TR).U,V - 9,10	52	8527.5	443430	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
27	23 B/P BRARI			8270	8/383	(TR).U,V - 9,10	71	8527.5	605452.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
28	I paidentifikuar			8269	8/353	(TR).U,V - 9,10	229	8527.5	1952797.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
29	I paidentifikuar			8270	8/107	(TR).U,V - 9,10	180	8527.5	1534950	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
30	I paidentifikuar			8270	8/293	(TR).U,V - 9,10	1016	8527.5	8663940	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
31	FLUTURA BRARI+B/P			8270	8/294	(TR).U,V - 9,10	403	8527.5	3436582.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
32	SHABAN BRARI+ B/P			8270	8/137	(TR).U,V - 9,10	1206	8527.5	10284165	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
33	HAXHI BRARI+B/P			8270	8/326	(TR).U,V - 9,10	1698	8527.5	14479695	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
34	23 B/P BRARI			8270	8/325	(TR).U,V - 9,10	210	8527.5	1790775	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
35	QAZIM	HAXHI	BRARI	8270	8/324	(TR).U,V - 9,10	662	8527.5	5645205	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
36	B/P BRARI, ALLA 7 VETE			8270	8/138	(TR).U,V - 9,10	300	8527.5	2558250	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi

37	FATMIR		BRARI	8280	1/91	(TR).U,V - 9,10	340	8527.5	2899350	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
38	FATMIR		BRARI	8280	1/92	(TR).U,V - 9,10	360	8527.5	3069900	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
39	I paidentifikuar			8280	1/7	(TR).U,V - 9,10	634	8527.5	5406435	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
40	XHELAL		ALLA	8280	1/11	(TR).X,Y - 9,10	3065	8527.5	26136787.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
41	5 B/P BRARI			8280	1/56	(TR).X,Y - 9,10	1500	8527.5	12791250	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
42	ATLIJE		BRARI	8280	1/61	(TR).X,Y - 9,10	723	8527.5	6165382.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
43	HAMID		BRARI	8280	1/60	(TR).X,Y - 9,10	20	8527.5	170550	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
44	TRSH. BRARI			8280	1/58	(TR).X,Y - 9,10	189	8527.5	1611697.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
45	QAZIM		BRARI	8280	1/57	(TR).X,Y - 9,10	1743	8527.5	14863432.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
46	NURI		PETI	8280	1/93	(TR).X,Y - 9,10	873	8527.5	7444507.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
47	VATH		PETI	8280	1/131	(TR).X,Y - 9,10	477	8527.5	4067617.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
48	14 B/P TRESA,DEMNERI,HIDRI			8280	1/97	(TR).X,Y - 11,12	2021	8527.5	17234077.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
49	6 B/P PETI			8280	1/120	(TR).X,Y - 11,12	1800	8527.5	15349500	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
50	AGRON		PETI	8280	1/70	(TR).X,Y - 11,12	360	8527.5	3069900	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
51	XHOVANE		GARUNJA	8280	1/86	(TR).X,Y - 11,12	659	8527.5	5619622.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
52	HATIXHE		GARUNJA	8280	1/87	(TR).X,Y - 11,12	1111.2	8527.5	9475758	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
53	TONE		GARUNJA	8280	1/88	(TR).X,Y - 11,12	1111.2	8527.5	9475758	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
54	HAXHIRE		GARUNJA	8280	1/89	(TR).X,Y - 11,12	508	8527.5	4331970	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
55	I paidentifikuar			8280	1/84	(TR).X,Y - 11,12	2349	8527.5	20031097.5	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
56	11 B/P XIBRI, BRAHJA			8280	1/72	(TR).X,Y - 11,12	280	8527.5	2387700	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
57	SHYQYRI	HYSEN	GARUNJA	3266	96/43	K-34-100-(27-A)	398	2622.165	1043621.67	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
58	KURT		BRAHJA	3266	96/34	K-34-100-(27-A)	415	2622.165	1088198.48	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
59	LULZIM		HUQI	3266	96/35	K-34-100-(27-A)	69	2622.165	180929.39	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
60	RAMAZAN		BRAHJA	3266	94/1/13	K-34-100-(27-A)	386	2622.165	1012155.69	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
61	FATOS		BRAHJA	3266	94/1/11	K-34-100-(27-A)	1011	2622.165	2651008.82	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
62	SAMI		BRAHJA	3266	94/1/9	K-34-100-(27-A)	1661	2622.165	4355416.07	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
63	I paidentifikuar			3266	94/13	K-34-100-(27-A)	1009	2622.165	2645764.49	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
64	ETEM		BRAHJA	3266	94/1/2	K-34-100-(27-A)	1905	2622.165	4995224.33	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
65	ARTUR		KOZMAI	3266	94/1/7	K-34-100-(27-A)	342	2622.165	896780.43	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
66	ARTUR KOZMAI; SHOQËRIA “Parazzu”			3266	94/5	K-34-100-(27-A)	942	2622.165	2470079.43	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
67	HALIT		BRAHJA	3266	93/1	K-34-100-(27-A)	352	2622.165	923002.08	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
68	HALIL		BRAHJA	3266	93/2	K-34-100-(27-A)	1692	2622.165	4436703.18	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
69	MEXHIT		BRAHJA	3266	93/3	K-34-100-(27-A)	222	2622.165	582120.63	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
70	I paidentifikuar			3266	93/4	K-34-100-(27-A)	1248	2622.165	3272461.92	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
71	XHEVAHIR		BRAHJA	3266	93/3/1	K-34-100-(27-A)	1331	2622.165	3490101.62	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
72	SHERIF		BRAHJA	3266	93/4/3	K-34-100-(27-A)	1225	2622.165	3212152.13	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
73	REXHEP		BRAHJA	3266	93/4/1	K-34-100-(27-A)	780	2622.165	2045288.70	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
74	I paidentifikuar			3266	91	K-34-100-(27-A)	2804	2622.165	7352550.66	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
75	NEXHMI		BRAHJA	3266	88/11	K-34-100-(27-A)	1138	2622.165	2984023.77	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
76	KOZETA		ALLA	3266	88/12	K-34-100-(27-A)	915	2622.165	2399280.98	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
77	SHYQYRI		BRAHJA	3266	88/5	K-34-100-(27-B)	1845	2622.165	4837894.43	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
78	EDMOND		BRAHJA	3266	88/6	K-34-100-(27-B)	2500	2622.165	6555412.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
79	MALIQ		BRAHJA	3266	88/7	K-34-100-(27-B)	1123	2622.165	2944691.30	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
80	LEONARD SOLIS;ILIR KARCINI; DHIMOSTEN KOCA			3266	85/1	K-34-100-(27-B)	985	2622.165	2582832.53	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi

81	LEONARD SOLIS;ILIR KARCINI; DHIMOSTEN KOCA		3266	84/18	K-34-100-(27-B)	2483	2622.165	6510835.70	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
82	UNIVERSITETI "New-York"		3266	84/17	K-34-100-(27-B)	383	2622.165	1004289.20	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
83	ALUSH	RESHIT	3266	84/4	K-34-100-(27-B)	401	2622.165	1051488.17	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
84	MALIQ	RESHIT	3266	84/5	K-34-100-(27-B)	524	2622.165	1374014.46	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
85	FERAT	RESHIT	3266	84/6	K-34-100-(27-B)	567	2622.165	1486767.56	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
86	SHYQYRI	RESHIT	3266	84/7	K-34-100-(27-B)	753	2622.165	1974490.25	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
87	HYSEN		3266	24	K-34-100-(27-B)	104	2622.165	272705.16	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
88	SAMI	MASAR	3266	86/7	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
89	ARBEN		3266	86/8	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
90	ASTRIT		3266	75/2/11	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
91	RITVAN DHE ZAMIRA GJINI		3266	75/68	K-34-100-(27-B)	87	2622.165	228128.36	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
92	RITVAN DHE ZAMIRA GJINI		3266	75/2/18	K-34-100-(27-B)	600	2622.165	1573299.00	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
93	ASTRIT		3266	36	K-34-100-(27-B)	297	2622.165	778783.01	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
94	HASAN	BAJRAM	3266	75/77	K-34-100-(27-B)	27	2622.165	70798.46	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
95	SKENDER	ISMAIL	3266	38	K-34-100-(27-B)	300	2622.165	786649.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
96	PERPARIM		3266	40	K-34-100-(27-B)	183	2622.165	479856.20	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
97	LEFTER		3266	41	K-34-100-(27-B)	50	2622.165	131108.25	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
98	BILBIL		3266	44	K-34-100-(27-B)	94	2622.165	246483.51	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
99	BUJAR		3266	42	K-34-100-(27-B)	113	2622.165	296304.65	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
100	ALBERT		3266	46	K-34-100-(27-B)	248	2622.165	650296.92	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
101	AHMET		3266	47	K-34-100-(27-B)	248	2622.165	650296.92	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
102	SIMON		3266	48	K-34-100-(27-B)	300	2622.165	786649.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
103	MARK		3266	51	K-34-100-(27-B)	154	2622.165	403813.41	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
104	ZENEL		3266	49	K-34-100-(27-B)	300	2622.165	786649.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
105	STILJANO		3266	50	K-34-100-(27-B)	300	2622.165	786649.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
106	NEKI		3266	60	K-34-100-(27-B)	20	2622.165	52443.30	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
107	FONDACIONI "EL-FURKAN"		3266	73/3	K-34-100-(27-B)	870	2622.165	2281283.55	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
108	PETRIT		3266	57	K-34-100-(27-B)	272	2622.165	713228.88	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
109	I paidentifikuar		3266	86/5	K-34-100-(27-B)	73	2622.165	191418.05	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
110	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	995	2622.165	2609054.18	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
111	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	5054	2622.165	13252421.91	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
112	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	573	2622.165	1502500.55	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
113	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	492	2622.165	1290105.18	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
114	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	2066	2622.165	5417392.89	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
115	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	1366	2622.165	3581877.39	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
116	I paidentifikuar		3266	75	K-34-100-(27-B)	490	2622.165	1284860.85	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
117	BESIM		3266	56	K-34-100-(27-B)	300	2622.165	786649.50	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
118	GJYLE		3266	58	K-34-100-(27-B)	54	2622.165	141596.91	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
119	I paidentifikuar		3266	70/7	K-34-100-(27-B)	178	2622.165	466745.37	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
120	ENVER	BAJRAM	3266	70/6	K-34-100-(27-B)	159	2622.165	416924.24	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
121	DALIP	ABAZ	3266	162/2	K-34-100-(27-B)	534	2622.165	1400236.11	Proces rikonfirmimi dhe saktësimi
	TOTALI					87854		459,462,661	

KËRKESË

Shtetasit, Nuriye Bathorja, Myslym Bathorja dhe Hamide Zenkollari (Bathorja) kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Skënder Bathorja, i biri i Shyqyriut dhe i Nuriyes, i datëlindjes 10.7.1970 dhe caktimin e z.Myslym Bathorja si kujdestar të administrimit të pasurisë së tij.

KËRKUES

Nuriye Bathorja
Myslym Bathorja
Hamide Zenkollari (Bathorja)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 16.5.2011
Doli nga shtypi më 18.5.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë